



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1024/2-5

Datë: 04/11/2020

Fakulteti: i Inxhinierisë Mekanike

Departamenti/Programi: Termoenergjetikë dhe energji e ripërtëritshme

Dosja nr.: _____

FORMULAR PËR MBROJTJEN E PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

Kryetari i Komisionit:

Prof. Dr. Rexhep Selimaj

Prishtinë, 29.04.2021, Salla Online, Koha 19.00

ZONJA DHE ZOTËRINJ!

Në bazë të Rregullores për studime master, më lejoni të hapi seancën për mbrojtjen publike të punimit master të kandidatës **BSc SAHADETE MALOKU**, me titull:

“Analiza tekniko-ekonomike e sistemeve fotovoltaike të përdorura në sektorin rezidencial me dhe pa aplikimin e baterive elektrike”.

Procedura në tërësi e kësaj mbrojtje ka rrjedhur si në vijim:

1. **Vendimi** mbi formimin e komisionit për vlerësimin e projekt propozimit të punimit të masterit në përbërje:

1. Prof. dr. Rexhep Selimaj, kryetar
2. Prof. dr. Xhevat Berisha, mentor
3. Prof. ass. dr. Bedri Dragusha

dhe caktimi i mentorit të temës, Prof. dr. Xhevat Berisha, sipas vendimit nr. 1024/2-5, datë 04.11.2020, të mbledhjes së Këshillit të Fakultetit të mbajtur me datën 02.11.2020

2. **Vendimi** nr. 462, datë 19.03.2021, mbi aprovimin e raportit të komisionit për vlerësimin e dorëshkrimit të punimit të diplomës master dhe formimi i komisionit për mbrojtje është aprovuar në mbledhjen e datës 21.04.2021, të Këshillit të Fakultetit, në përbërje:

1. Prof. dr. Rexhep Selimaj, kryetar
2. Prof. dr. Xhevat Berisha, mentor

Formulari – F4

3. Prof. ass. dr. Bedri Dragusha, anëtar

4. Prof. ass. dr. Drenusha Krasniqi, anëtare-rezervë.

- Në vazhdim, kryetari paraqet jetëshkrimin e kandidatit/es, ndërsa mentori paraqet në pika të shkurtra përmbajtjen dhe arsyeshmërinë e temës master.
- Kryetari i jep fjalën kandidatit/es, për mbrojtje të punimit të diplomës master në kohëzgjatje deri 30 min.
- Pas përfundimit të prezantimit, kryetari pyet kandidatin/en se a mund të vazhdohet me pyetje ose ka nevojë për një pauzë të shkurtër.
- Pas miratimit nga ana e kandidatit/es për vazhdim përkatësisht pas pauzës së shkurtër kryetari jep mundësinë për pyetje dhe diskutim.
- Së pari pyetje parashtrajnë anëtarët e komisionit dhe më pas edhe audienca. Në rast nevojë mund të ndihmoj ose të përgjigjet në pyetje edhe mentori i punimit të diplomës.
- Pas pyetje përgjigjeve dhe diskutimit, komisioni tërhiqet për këshillim dhe votim.
- Pas konsultimeve të komisionit për mbrojtje, kryetari shpall rezultatin e vlerësimit (të pranishmit në sallë ngritën në këmbë).

Zonja dhe zotërinj, komisioni duke vlerësuar idenë e projekt propozimit, metodat e hulumtimit, punën e kandidatit, shkrimin e temës, diskutimin publik, prezantimin dhe diskutimin merr këtë

VENDIM

Punimi i diplomës master vlerësohet me notë _____, prandaj, konstatojmë se janë plotësuar të gjitha kushtet me ligj që kandidates **BSc SAHADETE MALOKU** t'i jepet titulli:

Master i Inxhinierisë Mekanike

Programi: Termoenergjetikë dhe energji e ripërtëritshme.

Komisioni / Emri dhe mbiemri dhe nënshkrimi:

1. Prof. dr. Rexhep Selimaj, kryetar _____

2. Prof. dr. Xhevat Berisha, mentor _____

3. Prof. ass. dr. Bedri Dragusha _____